



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 11, datë 06.02.2024

PËR EMËRTIMIN E TRI OBJEKTEVE ARSIMORE TË REJA NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM DHE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ, NË BASHKINË DURRËS

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.114/2015, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Arsimit, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,



**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**


1. Miratimin e emërimit të Kopshtit të ri “Filizat e Vegjël” në fshatin Bizë, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës.
2. Miratimin e emërimit të Kopshtit të ri “Rreze Drite” në fshatin Kuçok, Njësia Administrative Manëz, Durrës.
3. Miratimin e emërimit të Çerdhes dhe Kopshtit “Lulet e Pranverës”, Njësia Administrative Manëz.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare dhe Ndërmarrja Rruga, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 07.02.2024



BASHKIA DURRE
15.02.24 Nr. 1492/3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 97 / Prot.
11

Durrës, më 15.02.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.11 datë 06.02.2024 “Për emërtimin e tri objekteve arsimore të reja në Njësinë Administrative Ishëm dhe në Njësinë Administrative Manëz, në Bashkinë Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

